



RELACION TEKNIK

Rehabilitimi dhe Mobilimi i Qendrës për Mirëqenie Psikosociale, Kukës Projekt i zbatuar në kuadër të programit #EU4SocialCare

I. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Objekti i ndërhyrjes:

Ky relacion teknik përgatitet në funksion të ndërhyrjes së parashikuar për rehabilitimin dhe mobilimin e Qendrës për Mirëqenie Psikosociale, Kukës e cila ndodhet në ambientet e ish-Shtëpisë së Oficerëve, kati I (i parë). Aktualisht kjo hapësirë është në përdorim nga Sektori i Shërbimeve Sociale, përkatësisht nga specialistët e ndihmës ekonomike dhe pagesave të paaftësisë në Bashkinë Kukës.

Qëllimi i ndërhyrjes:

Ky projekt synon krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe të specializuar për ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët, të rinjtë, prindërit/kujdestarët dhe grupet në nevojë të ekspozuar ndaj traumës, krizave apo situatave të vështira dhe të papritura. Qendra do të ofrojë një gamë të integruar shërbimesh të ndërhyrjes së hershme, këshillimit individual dhe në grup, ndërhyrjes në krizë dhe edukimit komunitar.

II. KUADRI INSTITUCIONAL I PROJEKTIT

Zhvilluesi i projektit:

Bashkia Kukës, në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë së saj për sigurimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale vendore.

Zbatuesit e projektit:

Terre des hommes – Misioni në Shqipëri në partneritet me Bashkinë Kukës, në kuadër të projektit “Zhvillimi i Shërbimeve të Specializuara – Qendra Multifunksionale për Mirëqenie Psikosociale Kukës”, si pjesë e programit #EU4SocialCare, financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri, zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Vendndodhja:

Objekti ndodhet në qytetin e Kukësit, brenda hapësirave të rikualifikuara të ish-Shtëpisë së Oficerëve, të akorduara me marrëveshje partneriteti ndërmjet Bashkisë Kukës dhe Terre des hommes, Misioni në Shqipëri.

Marrëveshja për përdorimin e hapësirës:

Në përputhje me marrëveshjen e partneritetit ndërmjet Bashkisë Kukës dhe Terre des hommes, ambientet do të përshtaten për zhvillimin e funksioneve të Qendrës për Mirëqenie Psikosociale, duke garantuar përmbushjen e standardeve teknike dhe funksionale të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të specializuara psiko-sociale.

III. OBJEKTIVAT KRYESORE TË NDËRHJRJES

- Përshtatja arkitektonike dhe funksionale e ambienteve ekzistuese sipas nevojave të shërbimit dhe kriterëve të aksesueshmërisë.
- Sigurimi i ndriçimit natyral dhe artificial i përshtatshëm në përputhje me funksionet e hapësirave të këshillimit dhe punës së stafit.
- Mobilimi i brendshëm me pajisje funksionale dhe ekonomike, në funksion të komoditetit dhe efikasitetit të shërbimeve.
- Përmirësimi i kushteve të mikroklimës së brendshme përmes sistemit të kondicionimit dhe shtrimit me parket ose materiale rezistente dhe higjienike.
- Krijimi i një mjedisi të ngrohtë, mikpritës dhe terapeutik, që ndihmon në reduktimin e stresit dhe përforcimin e ndjesisë së sigurisë dhe mirëqenies.

IV. PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT TË ZHVILLIMIT ARKITEKTONIK DHE MOBILIMIT

Në përputhje me kërkesat funksionale të projektit, hapësira është rikonceptuar në funksion të zhvillimit të shërbimeve të specializuara dhe gjithëpërfshirëse, përmes një planvendosjeje që optimizon qarkullimin, siguron kushte pune të përshtatshme dhe ofron mjedis të sigurt, të ngrohtë dhe të pranueshëm për përfituesit. Organizimi i brendshëm i ambientit është ndarë në gjashtë njësi funksionale të dallueshme:

1. Dhomë për *Ndihmën e Parë Psikologjike dhe Këshillim Individual për të rinjtë dhe prindër/kujdestar*– E menduar për të ofruar ndërhyrje të menjëhershme në situata krize, duke garantuar privatësi, siguri emocionale dhe komoditet psikologjik për përfituesit.
2. *Këshillim individual për fëmijë* – Ambient miqësor për fëmijët, me mobilim të përshtatur për moshën, ngjyra të buta dhe elemente tërheqëse që nxisin sigurinë dhe pjesëmarrjen.
3. Hapësirë për *këshillim në grup dhe aktivitete psiko-edukuese* – Projektuar si një sallë multifunksionale që përmbush nevojat për punë në grup, seanca ndërvepruese dhe trajnime.
4. *Hapësirë pune për stafin* – Zonë e përbashkët me ndarje xhami të tejdukshme për të ruajtur transparencën vizuale, bashkëpunimin dhe njëkohësisht për të garantuar fokusin në punë. Është e pajisur me mini-kuzhinë, hapësirë magazinimi dhe arshivimi.

5. *Ambient pritjeje për përfituesit dhe shoqëruesit* – Pajisur me mobilim të rehatshëm dhe elementë mikpritës për pritje dinjitoze dhe të qetë.
6. *Tualet dhe hapësirë për magazinim materialesh* – Funksionale dhe në përputhje me standardet higjieno-sanitare.

V. PËRSHKRIMI I ELEMENTËVE NDËRTIMORË DHE PËRSHTATJEVE INTERIORE

a) Gjendja ekzistuese – Përshkrim teknik i planimetrisë

Objekti ka një sipërfaqe të brendshme prej rreth 87 m², duke nisur me hyrjen dhe 3 zyra me sipërfaqe minimale edhe një tualet. Për sa i përket lartësisë ky parametër lëviz në dy nivele që janë 2.6 m në ambientet e zyrave deri në 3.7 m në sallën e hyrjes.

Muret perimetrale janë me trashësi 50 cm, ndërtim i realizuar me muraturë klasike, duke siguruar një strukturë solide dhe të qëndrueshme. Muret ndarës të brendshëm kanë trashësi që varion nga 10 cm deri në 20 cm.


Objekti është i pajisur me derën hyrëse dhe 3 dyer të brendshme me përmasa të ndryshme (70x210 cm, 80x240 cm dhe 180x240 cm), si dhe një hapësirë kalimi pa derë. Hyrja kryesore është me dyer dopio me përmasa 180x240 cm.

Zona hyrëse çon në një ambient qendror me sipërfaqe rreth 40 m², i cili ofron akses në tri dhoma të tjera dhe një tualet. Dy nga dhomat kanë sipërfaqe të vogla, secila rreth 9–10 m², me lartësi 2.6 m. Një dhomë anësore dhe tualeti kanë lartësi më të madhe, prej 3.7 m.


Gjendja ekzistuese e objektit shoqërohet me foto të ambientit dhe planvendosje të detajuar, të cilat ilustrojnë konfigurimin aktual të hapësirave, përmasat, përbërjen ndërtimore dhe elementët funksionalë të objektit. Këto materiale vizuale shërbejnë si referencë për vlerësimin e nevojave për ndërhyrje rehabilituese dhe mobilim funksional.

PLANIMETRIA E GJENDJES EKZISTUESE

HYRJA
→



****FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE***



PLANVENDOSJE E GJENDJES EKZISTUESE



GJENDJA EKZISTUESE

Kjo gjendje ekzistuese paraqet bazën për planifikimin dhe organizimin e rehabilitimit dhe mobilimit, duke evidentuar nevojën për përshtatje funksionale, përmirësim të ndriçimit dhe përmirësim të kushteve për ofrimin e **shërbimeve psikosociale cilësore për grupet e targetuara**.

b) Riorganizimi Funksional dhe Ndërhyrjet Arkitektonike në Ambientet e Brendshme

Në funksion të krijimit të një mjedisi funksional, gjithëpërfshirës dhe të përshtatur me kërkesat e modelit të shërbimeve psikosociale për përfitues të ndryshëm (fëmijë, të rinj, familje në nevojë), është hartuar një plan ndërhyrjeje, që synon riorganizimin e hapësirave të brendshme ekzistuese përmes zgjidhjeve arkitektonike dhe ndërtimore të fokusuara në:

Planimetria e Propozuar

- Vendosja e *dritareve të reja dopio xham me profil alumini* (5.251 m²) dhe *dyerve të brendshme druri me cilësi të lartë* (25.098 m²) përmirëson izolimin termik/akustik, sigurinë dhe komoditetin e ambienteve.

B3) Përmirësimi i dyshemesë dhe shtresave mbështetëse

- Është kryer *heqja e pllakave ekzistuese të dyshemesë* (47.285 m²), dhe shtresa e re është realizuar me **beton C 7/10**, mbi të cilën janë vendosur sipas rastit:

Parket druri (47.285 m²) në hapësirat e parashikuara për dhomat e këshillimit individual,

- dhe *pllaka gresi importi 40x40 cm* (44 m²) në ambiente me ngarkesë më të lartë ose kontakt me ujë që janë ambientet e hyrjes, pjesa e pritjes dhe zyra e stafit.

B4) Punime për përmirësimin e tavanit dhe akustikës


- Është parashikuar *ulja e tavanit* me gips-karton në një sipërfaqe totale prej **25.095 m²**, për të optimizuar shpërndarjen e ndriçimit artificial dhe për të përmirësuar akustikën në ambientet funksionale të qendrës.
- Të gjitha sipërfaqet e brendshme duhet te suvatohen me llaç M25 për qëndrueshmëri.
- Riparim dhe suvatim i soletës ekzistuese mbi dhomat e këshillimit (lartësia 2.60 m), e cila shërben si tarracë në katin e dytë, për të parandaluar depërtimet e ujit dhe dëmtimet nga agjentët atmosferikë; ndërhyrja është e nevojshme për të garantuar integritetin e strukturës dhe funksionalitetin e hapësirave nën të.

B5) Ndriçimi artificial dhe sistemet elektrike mbështetëse

- Është instaluar një *sistem ndriçimi artificial* i përbërë nga:
 - *6 ndriçues tavanorë (plafoniere) me llamba fluoreshente 40Ë,*
 - *priza dhe çelësa të sistemit elektrik* (10A me nulifikim, 15 copë),
 - *kuadër ndriçimi dhe rrjetëzimi me përcjellës PV-500 Ø 2.5 mm²*, në një gjatësi prej 100 ml.

Zgjidhja e ndriçimit është projektuar për të siguruar shpërndarje të barabartë, **ndriçim të ngrohtë dhe jo agresiv**, në përputhje me kërkesat për një ambient pune dhe pritjeje komod.

PLANI I KATIT PERDHE (NDRIÇIMI)



Janë parashikuar 3 grila të brendshme vertikale për ambientet e brendshme të zyrave, të përbëra nga material tekstil i qëndrueshëm dhe me rezistencë ndaj rrezeve UV. Zgjidhja synon kontrollin e ndriçimit natyral dhe rritjen e komoditetit vizual gjatë orëve të punës. Grilat janë të përshtatura me dimensionet e dritareve dhe estetikën e ambientit.

B6) Ngrohja dhe Klimatizimi

Në funksion të garantimit të kushteve të përshtatshme termike për ofrimin e shërbimeve dhe qëndrimin e përfituesve në qendër, është propozuar **instalimi i dy kondicionerëve murale me kapacitet 18 BTU**, të pajisur me funksione të integruara për **ngrohje dhe ftohje e treguar ne planimetrinë me sipër**. Propozohet pajisja me njësi kondicionimi për dhomën e këshillimit në grup dhe zyrën e përbashkët të stafit, me qëllim garantimin e kushteve optimale termike dhe përmirësimin e komfortit gjatë ofrimit të shërbimeve. Këto dy ambiente konsiderohen ndër më funksionale dhe më të frekuentuarat në strukturë, ndaj instalimi i sistemeve të klimatizimit është i domosdoshëm për të përballuar si temperaturat e ulëta dimërore, ashtu edhe ato të larta verore.

Pajisjet janë të pozicionuara në mënyrë strategjike për të mbuluar në mënyrë optimale hapësirat me përdorim të vazhdueshëm, duke garantuar:

- shpërndarje të njëtrajtshme të temperaturës;

- eficiencë energjetike në përdorim;
- mirëqenie termike të stafit dhe përfituesve në çdo sezon.

B7) Lyerja e brendshme

Për të garantuar një mjedis estetikisht të këndshëm dhe në përputhje me standardet e shërbimeve psiko-sociale, është parashikuar aplikimi i **bojës hidroplastike me cilësi të lartë që përfshin sipërfaqen e mureve dhe atë të tavaneve që zënë 271m²**, me rezistencë ndaj lagështirës dhe mbulueshmëri të mirë të sipërfaqeve të suvatuara. Lyerja do të aplikohet në të gjitha sipërfaqet e brendshme të ambienteve të rehabilituara (mure dhe tavane), duke kontribuar në krijimin e një atmosfere të pastër, të qetë dhe të mirëmbajtur.

Ky trajtim final shërben si për të përmyllur ndërhyrjet e suvatuara, ashtu edhe për të siguruar **mbrojtje afatgjatë dhe lehtësi në mirëmbajtje**, në përputhje me kërkesat funksionale dhe higjieno-sanitare të objektit.

VI) Planimetri e Mobiluar dhe Pajisja Funksionale e Hapësirave të Brendshme të Qendrës

Plani i mobilimit është hartuar me synimin për të maksimizuar funksionalitetin, komoditetin dhe aksesueshmërinë e hapësirave, në përputhje me natyrën e shërbimeve psikosociale që do të ofrohen në qendër. Pajisjet dhe elementët e përzgjedhur janë të orientuar drejt krijimit të një mjedisi mikpritës, profesional dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të përfituesve, duke mbështetur ndërhyrjen psikologjike dhe veprimtarinë e përditshme të stafit.

Ambienti i Ndihmës së Parë Psikologjike dhe Këshillimit Individual për të Rinj dhe Të Rritur. Ky ambient është konceptuar si një hapësirë e qetë dhe mikpritëse për ndërhyrje në krizë dhe seanca individuale. Mobilimi përfshin:

- 1 Tavolinë zyre, 200cm X 90 cm, ngjyra druri bezhe e hapur + komedinë tavoline zyre, 3 sirtarë, 1 me celes, melamine.
- 2 Karrige zyre, mbështetëse rrjetëzuar, ulëse veshje tekstili, krahë PP, e zezë, 58x60xH93-103 cm
- 2 Raftë me kanata, me çelës (për akses të limituar), 190X100X50cm, ngjyra druri bezhë e hapur për arshivimin e dosjeve të përfituesve dhe mjeteve didaktike.
-

Ambienti i Këshillimit Individual për Fëmijë. Ky ambient është mobiluar me ndjeshmëri të veçantë për të ofruar një mjedis miqësor për fëmijët. Pajisjet përfshijnë:

- Raft pa kanate (biblioteke) 190 X70X45, ngjyra druri bezhe e hapur
- Raft me kanata, me celës (për akses të limituar), 190X100X50cm, ngjyra druri bezhë e hapur.
- Tavolina zyre, 200 cm X 90 cm, ngjyra druri bezhe e hapur + komedina tavoline zyre, 3 sirtare, 1 me celes, melamine
- 1 Karrige zyre, mbështetëse rrjetëzuar, ulëse veshje tekstili, krahë PP, e zezë, 58x60xH93-103 cm

Ambienti i Këshillimit në Grup dhe Aktivitetet Psiko-Edukuuese. Ky ambient është konceptuar për zhvillimin e seancave në grup, aktiviteteve ndërvepruese dhe mbledhjeve të brendshme. Mobilimi përfshin:

- Tavolinë mbledhjeje (300 x 140 cm), ngjyrë druri bezhë e hapur,
- 10 karrige zyre statike, pa krahë, me strukturë metalike dhe tapiceri tekstili ngjyrë e zezë.
- Raft i hapur, horizontal 80 X 200X40 për mjete didaktike.
- Tavolinë pune për fëmijë, ngjyrë druri e hapur,
- Dy karrige për fëmijë, druri, në përmasa të përshtatura
- 2 beanbags (thasë me kokrriza për ulje), në ngjyrë jeshile dhe të verdhë,
- Tendë projektori murale (150 x 150 cm),
- Tabelë magnetike për prezantime (120 x 240 cm),
- Varëse rrobash (tip “prift”),
- Vazo dekorative me lule, diametër 40 cm.
- Tabela Flipchart 65x100 cm, Materiali: Plastikë dhe alumin, Tre këmbë me veshje gome për stabilitet
- Kondicioner 18 BTU + shërbim montimi
-

Ambienti i Stafit. Për stafin është parashikuar një ambient pune i shkrirë me një ambient minikuzhine që përfshin:

- 2 tavolina zyre (200 x 90 cm), ngjyrë druri bezhë e hapur&2 komedinë zyre me tre sirtarë, një prej të cilëve me çelës,
- 2 karrige zyre me mbështetëse rrjetëzuar, krahë PP dhe ulëse tekstili,
- 2 Raftë pa kanate (biblioteke) 190 X70X45, ngjyra druri bezhe e hapur
- Mini-kuzhinë modulare (200 cm) për përgatitjen e pijeve,
- Frigorifer mini-bar (kapacitet 93 L, klasë energjie A+),
- Mini-ekspres kafeje për përdorim të përditshëm.
- Kondicioner 18 BTU + shërbim montimi

Ambienti i Pritjes (Salloni hyrës), Hapësira e pritjes është konceptuar për të krijuar një ambient komod dhe mikpritës për përfituesit, I cili ndodhet hyrje përballë derës kryesore hyrëse. Pajisjet e propozuara përfshijnë:

- 2 sete karrigesh treshe për pritje, me tapiceri stofë dhe skelet metalik, ngjyrë blu,
- Tavolinë e vogël mesë, për vendosjen e materialeve ose elementëve mbështetës,
- 1 vazo dekorative me lule, diametër 40 cm,
- Kutitë transparente me çelës (20 x 20 cm), për mbledhjen e sugjerimeve apo njoftimeve të përdoruesve.

Ambienti i Shërbimit Sanitar. Për të optimizuar hapësirën dhe organizimin e pajisjeve ndihmëse, në tualet është propozuar:

- Raft tualeti 100x50x90

3D PERFUNDIMTARE



Propozimi i projektit vijon me realizimin e modelit tridimensional (3D), i cili synon të evidentojë në mënyrë më të detajuar dhe vizuale vendosjen e mobiljeve, dyerve, hyrjeve, si dhe specifikimet e teksturave dhe ngjyrave të përcaktuara për ambientin. Ky model 3D do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për vlerësimin final të dizajnit dhe funksionalitetit të hapësirave të brendshme.







Karriget e paraqitura në imazh janë vendosur vetëm për efekt vizual; në praktikë është parashikuar përdorimi i karrigeve statike, pa mbështetëse për krahët, të përshtatshme për funksionin e hapësirës. Karriget me rrota janë parashikuar të vendosen vetëm në pozicionet e tavolinave të zyrës, në funksion të nevojave ergonomike të stafit dhe perfituesve gjatë punës së përditshme, si dhe këshillimeve .

Përfundim

Në përmbushje të objektivave të projektit dhe nevojave funksionale të Qendrës për Mirëqenie Psikosociale, janë propozuar ndërhyrje të shumanshme arkitektonike dhe teknike, të cilat synojnë përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e komoditetit dhe sigurisë së përdoruesve, si dhe garantimin e një ambienti të përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve cilësore.

Riorganizimi funksional i hapësirave, përdorimi i ndarjeve me xham, përmirësimi i ndriçimit natyral dhe artificial, instalimi i sistemeve të ngrohjes dhe klimatizimit, si dhe mobilimi i përshtatur sipas nevojave specifike të stafit dhe përfituesve, janë elemente kyçe që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe efikas.

Ky projekt, i realizuar me standarde të larta profesionale, do të sigurojë kushtet e duhura për funksionimin optimal të qendrës, duke i përmbushur kërkesat dhe pritshmëritë e palëve të përfshira dhe duke garantuar një ndikim pozitiv në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale në komunitet.